

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 293, Datë 13.11.2025

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 93, DATË 28.04.2025
“MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË ALOKIMIT TË KAPACITETEVE DHE
MENAXHIMIT TË KONGJESTIONEVE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, me nr. 2829 prot., datë 11.11.2025, “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 93, datë 28.04.2025 “Mbi miratimin e Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 93, datë 28.04.2025, miratoi “Rregulloren për Alokimin e Kapaciteteve dhe Menaxhimin e Kongjestioneve (CACM)”, e cila transpozon Rregulloren (BE) 2015/1222, në zbatim të Vendimit nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.
- Vendimi nr. 93/2025 u botua në Fletoren Zyrtare nr. 92, datë 29.05.2025, duke përcaktuar se rregullorja hyn në fuqi pas botimit.

1. Komunikimi dhe rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë

- Sekretariati, me komunikimin elektronik të datës 14.02.2025, përcolli qëndrimet dhe rekomandimet mbi procesin e miratimit të Rregullores CACM, duke vlerësuar nevojën për saktësimin e aplikueshmërisë së saj për Republikën e Shqipërisë dhe përshtatjen e dispozitave me kompetencat kombëtare të ERE, OST sh.a. dhe ALPEX.
- Në të njëjtin komunikim, Sekretariati theksoi se miratimi i rregullores nga ERE, përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri sektorial, ka efekt të kufizuar praktik, pasi zbatimi i plotë i saj kërkon transpozimin e Paketës së Integritimit të Energjisë Elektrike dhe konfirmimin e përputhshmërisë nga Sekretariati.

2. Zhvillimet ligjore dhe institucionale

- Faza e konsultimit publik për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015 ‘Për sektorin e energjisë elektrike’” u zhvillua gjatë periudhës 01.07.2025 – 29.07.2025. Ky projektligj synon harmonizimin e legjisllacionit bazë me Paketën e Energjisë së Pastër (Clean Energy Package) dhe përcaktimin e rolit institucional të ERE, OST sh.a. dhe ALPEX në proceset e bashkimit të tregjeve.
- Në këtë kuadër, konsiderohet e nevojshme që hyrja në fuqi e Rregullores CACM të sinkronizohet me hyrjen në fuqi të ligjit të ri sektorial, për të siguruar koherencë juridike dhe zbatim efektiv.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, një akt administrativ mund të ndryshohet ose shfuqizohet nga organi publik që e ka nxjerrë, kur paraqiten rrethana të reja ligjore ose faktike.
- Në rastin konkret, për shkak të zhvillimeve ligjore që lidhen me procesin e miratimit të ligjit të ri “Për sektorin e energjisë elektrike”, vlerësohet e arsyeshme shtyrja e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 93/2025 deri më datë 1 korrik 2026, për të siguruar që zbatimi i rregullores të bëhet mbi një bazë ligjore të përditësuar.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Shtyrja e hyrjes në fuqi nuk përbën ndryshim material të përmbajtjes së Rregullores CACM, por vetëm harmonizim të efekteve të saj juridike me kuadrin ligjor në zhvillim.
- Ky ndryshim garanton siguri juridike, parashikueshmëri dhe përputhshmëri me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Në vendimin nr. 93, datë 28.04.2025, bëhet ndryshimi si vijon: “*Ky vendim hyn në fuqi më datë 1 korrik 2026.*”
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI